

**P nr.403/13**

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NE PEJE**, Departamenti i Krimeve te Renda, ne trupin gjykues te përberë nga Gjyqtaret : Lumturije Muhaxheri kryetare e trupit gjykues – gjyqtareve, Violeta Husaj Rugova dhe Kreshnik Radoniqi anëtar, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Shpresa Kërnya, në çështjen penale kundër të akuzuarit, L.R, nga ..., për shkak të veprës penale shpërdorim i detyrës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par.1 të KPK, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore – Departamenti për Krime të Rënda në Peje, PP.nr.76/13 dt.14.03.2013, në seancat e shqyrtimeve gjyqësore, publike të mbajtura me dt.17.09,2014, 28.10.2014, 14.11.2014, 05.12.2014 dhe 09.12.2014, në praninë e Prokurorit te Shtetit – Sahide Gashi, të akuzuarit L.R dhe mbrojtësi i tij avokat ..., nga ..., sipas autorizimit, përfaqësueses së Spitalit Regjional në Peje – M.S, me dt.11.12.2014, murr me dt.05.01.2015, përpiloi këtë :

## **A K T G J Y K I M**

**I akuzuari L.R**, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit nr...., i lindur me ..., në ..., ku dhe jeton , i biri i Sh nënës Sh, e gjinisë N, ka të kryer .... , Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, me pare i pa dënuar dhe ndaj të njëjtit nuk zhvillohet procedurë tjetër penale.

**Konform nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPPRK**

## **LIROHET NGA AKTAKAUZA**

**Gjëja se:**

Gjate periudhës ..., ne ..., si person zyrtar-Internist, me qellim te përvetësimit te dobisë pasurore te kundërligjshëm për vete , ka shpërdorë detyrën zyrtare, ne atë mënyrë qe pas marrëveshjes paraprake me pronarin e klinikes private për sëmundje te zemrës "...", e më vonë "...", ne ..., H.B, ka dërguar pacient nga reparti i,, ...'s për vendosje te stendave, për te cilat ka marre shpërblim nga i njëjti për çdo pacient shumën prej 300-400 €, gjithsejtë ne këtë mënyrë ka përfituar shumën prej 1.500 € (njëmijepesëqind) euro,

- me çka kishte për të kryer vepër penale shpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 339 par.1 të KPK.

Shpenzime e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore ne Peje-Departamenti i Krimeve te Renda, ka ngrit aktakuzë PP.nr.76/13 dt.14.03.2013, kundër te akuzuarit L.R, nga Peja, për shkak të veprës penale shpërdorim i detyrës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par.1 të KPK.

Gjykata ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor ne te cilën, te akuzuarin e ka njoftuar me te drejtat e tija nga neni 323 te KPPRK-se, si dhe pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurores se Shtetit PP.nr.76/13 dt.14.03.2013, në seancën e shqyrtimit gjyqësor, gjykata është bindur së i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe duke vepruar në kuptim të nenit 325 të KPPRK, të akuzuarit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë. Me këtë rast, gjykata e ka udhëzuar të akuzuarin për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë në kuptim të nenit 248 par.1 pika 1.1,1.2.1.3 të KPPRK-se, kështu që i akuzuari nuk e pranon fajësinë për vepër penale qe i vihet ne bar, ashtu qe gjykata shqyrtimin gjyqësor e ka vazhduar me procedurën e provave.

Prokuroja e shtetit - Sahide Gashi, para leximit të shkresave provave material, hoqi dorë nga administrimi i provave nën piken 4, për sa i përket Bankës Kreditore, ...-... dhe ..., mbetet që të administrohen transaksionet nga ... Banka, si dhe heq dorë nga administrimi si prova në shqyrtimin gjyqësor propozimit nën piken 9, që ka të bëj me historikun e sëmundjeve të pacientëve të shtrirë në spitalin Intern të Spitalit regjionale në ..., për sa i përket provave tjera mbetet pranë atyre provave. Fjalën e saj përfundimtare e ka përgatitur me shkrim, te cilën e elaboroi dhe është pjese përbërës e procesverbalit te shqyrtimit gjyqësor, mes tjerash ka theksuar, se me të gjitha provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, qoftë materiale dhe personale, është vërtetuar përtej çdo dyshimi se i akuzuari ka kryer veprën penale ashtu siç është përshkruar në diapozitiv të aktakuzës, duke i analizuar te gjitha provat një nga një siç janë: Listat me pacient te dërguar ne Spitalin Privat ne ..., e siguruar ne Spitalin Regjional ne ..., kjo konfirmohet edhe nga shkresat zyrtare te Drejtorit te këtij spitali .S.D, pastaj Rregullorja e brendshme e këtij Spitali dhe, Urdhëresën nr.414/1 e dt. 08.09.2011, se cili mjek kujdestar është i obliguar qe pacientet te cilët nuk mund te trajtohen ne Spitalin Rajonal ne ..., pikë referuese e kanë QKUK-ën, siç thuhet edhe ne njoftimin e Drejtorit Z.D nr.01/526/1 e dt.01.10.2012, raporteve dhe kërkesave te NJHKEK –ës, ne ..., nga listingu i thirrjeve telefonike mes te akuzuarit dhe pronarit te Spitalit Privat H.B nga përmbajtja e SMS-ve mes tyre, dëshmia e dëshmitarit A.G, nga transaksionet bankare te akuzuarit, ku shifen te hollat qe i ka pranuar nga ky i fundit, ne lidhmëni me njëra tjetrën, e vërteton përtej çdo dyshimi se ka ekzistuar marrëveshja mes tij dhe pronarit, këtu dëshmitari H.B, për te cilin kjo prokurori ka iniciuar rast dhe i është dërguar ne kompetence Prokurorisë Themelore ne Gjakove, e kjo marrëveshje buron nga veprimet e tyre , siç është fakti se edhe personalisht i akuzuari ka dërguar pacient ne këtë spital privat dhe atë siç thotë rregullisht. Andaj nga të gjitha të thënat, me të drejt pret që trupi gjykues të njëjtin ta shpalli fajtor, ta dënoj komfor ligjit, e po ashtu për veç dënimit kryesor propozon qe te njëjtit ti shqipton dënimin plotësues – ndalimin e ushtrimit te funksioneve ne administratën publike ose shërbimin publik komfor nenit 54 par.1 e 2 nen par.3 te KPK, gjithashtu te njëjtin ta obligoi ne pagimin e shumës se te hollave e cila i përgjigjet dobisë se fituar pasurore prej 1.500 €.

Mbrojtësi i te akuzuarit L.R avokati H.N, fjalën e tij përfundimtare e ka përgatitur me shkrim te cilën e elaboroi dhe është pjese përbërës e procesverbalit te shqyrtimit gjyqësor, mes tjerash ka theksuar se aktakuza është e mangët e pa qarte dhe i mungon përshkrimi faktik dhe i plote për faktet vendimtare dhe veprimet e ndërmarra nga i akuzuari qe ndërliiden me veprën penale te keqpërdorimit te detyrës zyrtare apo autorizimit nga neni 339 par.1 te KPK-se, duke cekur ne tersi atë qe është shënuar ne dispozitiv te akuzues. Shton se ne aktakuze nuk është cekur e as

gjate rrjedhës se procedurës penale te kësaj çështje, nuk është vërtetuar se kur dhe çfarë lloj marrëveshje paraprake ka lidhur i akuzuari me H.B, a ishte ajo marrëveshje konsensuale, pra verbale apo formale e shkruar, se cilat na qenkan te drejtat dhe detyrimet reciproke te subjekteve te kësaj marrëveshje. Ne aktakuzë ne mënyrë te përgjithësuar thuhet se i akuzuari ka dërguar pacient ne Klinikën ne fjalë, për vendosjen e stendave për te cilat ka marre shpërblim nga i njëjti për çdo pacient 300-400 €, pra në akuzë nuk është saktësuar numri i pacienteve qe i akuzuari i ka dërguar ne klinikën ne fjalë për trajtime operative dhe stendim e as shumat në para te cilat i akuzuari i ka pranuar nga H.B, për secilin pacient te dërguar veç e veç, gjithashtu ne asnjë fletë lëshim te Spitalit regional te ... sipas te cilave pacientet janë dërguar për trajtim te mëtejme mjekësor specialistik nga miokardi i zemrës nuk gjendet nënshkrimi i akuzuarit Dr. L R.

Nga aktakuzat dhe provat ne te cilat mbështetet ajo, nuk mund te dihet se kush është i dëmtuar ne këtë çështje penale juridike ne çka konsiston demti i shkaktuar sa ishte lartësia e demtit dhe si është vërtetuar se i akuzuari ka fituar pasuri te kundërligjshme me udhëzimin apo dërgimin e pacienteve ne spitalin "...", ne ...

Nga provat e administruara ne shqyrtim gjyqësor, si dëgjimi i dëshmitarëve A.G, H. B dhe provat tjera materiale, nuk janë vërtetuar elementet e veprës penale qe i vihet ne barre te akuzuarit. Vlen te theksohet, se nga raporti i Bankës "...", nuk është vërtetuar se shuma prej 1.500 €, është transferuar ne xhirollogarinë e te akuzuarit pikërisht ne emër te dërgimit te pacienteve te sëmur nga zemra dhe vendosje e stendave. Nga parashtrësia e përf. Ass B.Z - Drejtor i Klinikës se Kardiologjisë, invasive te QKUK, nr. 807 te dt. 28.02.2014, drejtuar Ministrisë te Shëndetësisë se Kosovës, rezulton se infarkti akut nuk është trajtuar, nuk trajtohet e, as qe do te trajtohet edhe ne një te ardhme te afërt ne QKUK.

Andaj ne baze te asaj qe u theksua me larte , i propozon trupit gjykues qe me rastin e vendosjes ne këtë çështje penale e bazuar ne nenin 364 par.1 pika 1.3 te KPPRK-se, te mbrojturin e tij L.R, ta liroj nga akuza, sepse nuk është vërtetuar se i njëjti ka kryer veprën penale te keqpërdorimit te detyrës zyrtare apo autorizimit nga neni 339 par.1 te KPK-se.

I akuzuari L.R, ne fjalën e tij përfundimtare deklaroi, se pajtohet në tërësi me fjalën përfundimtare të mbrojtësit, duke shtuar se gjatë punës si mjek - mjeku takohet me situata të ndryshme ku luftohet për jetën e njeriut, ku ka raste humbet ajo betejë. Sulmohet nga familjarët se nuk ke bërë asgjë, nuk je mjek i mirë dhe atëherë normal se ka ankesë është drejtori shefi, etj. Është i lumtur që gjatë gjithë viteve si mjek nga viti 1997, nuk ka pas ankesë ndaj tij, detyra e mjekut internist është të luftoj drejte për jetë me vdekjen, mjeku kirurg e kryen detyrën, detyrën post operatore, vdekjet i konstatojmë ne, ne e luftojmë vdekjen, shumë njerëzve ju ka shpëtuar jetën dhe nuk ka ndodhur me shku dikush e me i thënë se e ka marr në qafë dhe, kur karakteri i tij nuk e lejon të korruptohet për 300-400 euro, i vetmi pacientë është A.G, i cili ka shkuar ne gjendje të rëndë dhe familjarët e tij kanë vendosur, vajza e motrës së tij punon në njësinë koronare dhe e din se çka është infarkti, familjarët duke e pa gjendjen e tij kanë vendosur për dërgimin e tij në .... I vetmi pacientë që me katër stenda ka bërë ergometrin ka qenë A.G, kërkon qe te mos trajtohet si kriminel dhe mashtrues.

Gjykata gjate shqyrtimit gjyqësor administroi këto prova, mbrojtjen e te akuzuarit, dëgjimin e përfaqësueses se Spitalit Regjional ne ... , dëgjimin e dëshmitarëve, A.G dhe H.B, lexoi: urdhëresën e gjykatës për nxjerrjen e provave masave të fshehta teknike PN nr.494/12 dt.08.11.2012, urdhëresën e Spitalit Rajonal në ..., nr.414/1. dt.08.09.2011, shkresën zyrtare te

spitalit regional në ..., nr.01/506/1 dt.01.10.2012, Transaksionet e akuzuarit në Bankën ..., fletë lëshimi me epikrizë nr.3615 dt.12.11.2012, deklarata e akuzuarit e dhënë ne polici me dt.19.03.2013, dhe në prokuroi me dt.26.07.2013, lexohet lista e pacientëve të transferuar për korona rografi-a nga Njësia Koronare e muajit Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj, Qershor, Korrik, Gushtë, Shtator të vitit 2012, deklarata e prëf. e Spitalit Rajonal në ..., e dhënë ne prokurori, rezultatet nga masa e fshehtë - listingu i thirrjeve telefonike në mes të akuzuarit dhe H. B, si dhe SMS-ve, në mes tyre kryesisht gjatë vitit 2012, datave të ndryshme. Shikohet në certifikatat e pjesëmarrjes së këtu të akuzuarit në Seminare dhe kongrese, Lexohet një shkresë e Ministrisë se Drejtësisë e dt.03.06.2013, nr.reference 10-E-018-013 dhe lexohet shkresa e dt.28.02.2014 nga Prof, B.Z ushtrues detyre Drejtor i Klinikës së Kardiologjisë dhe angiologjisë, drejtuar Ministrit të shëndetësisë Prof. Dr.F.A nr.protokoli 807 – Arkivi i QKUK-së.

Gjykata ne shqyrtim gjyqësor i ka nxjerr te gjitha provat e duhura dhe pas vlerësimit te tyre te gjithanshëm, secilës veç e veç e ne lidhje reciproke me provat tjera komfor nenit 361 par.1 dhe 2 te KPPRK dhe pas vlerësimit te tyre, është vendosur si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi nga arsyet si ne vijim.

Sipas propozimit te prokurorisë se shtetit, është dëgjuar përfaqësuesja e Spitalit Rajonal në ..., M.S, e cila ne deponimin e saj pos tjerash ka deklaruar se me veprimet e ndërmarra nga i akuzuari për periudhën kohore 2007-2012, si mjek specialist nga reparti i Interno's nuk i është shkaktuar kurrfarë demi Spitalit Regjional ne ..., gjithashtu ka shtuar se asnjëherë deri me tani spitali ne fjale nuk ka pasur kurrfarë vërejtje ne punën e te akuzuarit. Ne fund deklaroi se nëse këtu i akuzuari shpallet fajtor nga gjykata, Spitalit Regjional do ti bie vetëm imazhi.

Sipas kësaj gjykate e, qe rezulton edhe nga dispozitivi i akuzës dhe provat ne te cilat mbështetet ajo, nuk mund te dihet se kush është i dëmtuar ne këtë çështje penalo juridike, ne çka konsiston demi i shkaktuar, një herrit edhe prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare kërkon nga gjykata qe te akuzuarin pos tjerash edhe ta obligoi ne pagimin e shumes se te hollave e cila i përgjigjet dobisë pasurore te fituara ne shumë prej 1.500 €, duke mos e cekur se kujt duhet ti behet pagesa e kësaj shume (kush është i dëmtuar sipas prokurorit).

Nga dëshmitari respektivisht pacienti A.G, nga ..., Gjykata ka vërtetuar këto fakte, se për shkak te përkeqësimit te gjendjes se tij shëndetësore ne fund te vitit 2011, fillimi i vitit 2012 (ka qene bore e madhe), i njëjti si rast urgjent është dërguar ne emergjencën e Spitalit Regjional ne Peje, me ç, rast mjeket specialist te Interno's Dr.D.M dhe L.R, si dhe personeli tjetër mjekësor i kanë ofruar ndihmën përkatëse mjekësore dhe pas kryerjes se analizave mjekësore, i është caktuar diagnoza angjinë para infarkt, e meqë dëshmitari ishte ne gjendje te rendë shëndetësore dhe i është dashur mjekimi i menjëhershëm ne ndonjë nga Klinikat apo Institucion i specializuar për këtë lloj sëmundje. Ka kërkuar qe te dërgohet ne Spitalin e ... ( Klinikën Private për te sëmurë të zëmrës "...", e me vone i quajtur "...” ne .... Në repartin e Interno's në ... ka qëndruar nga ora 17:00 deri rreth orës 20:00, e në ndërkohë meqë djali i motrës se tij Dr.S.U, ne atë spital është mjek ..., tërë kohën i ka qëndruar pranë. Pasi është njoftuara nga mjekët për diagnozën e tij dhe të njëjtit i kanë thënë në këtë gjendje je dhe vepro si të duash, si dhe duke marr parasysh se në këtë gjendje ka qenë edhe gruaja e vëllait dhe dhëndri - burri i motrës,e të njëjtëve ju është ofruar ndihmë në Spitalin e ..., ka kërkuar nga motrat që ta vazhdoj shërimin në ..., kishte njohuri edhe për Spitalin në ..., që edhe atje mundë të drejtohet, por meqë ... ishte më afër 30 km, vendosi të shkoj në .... Për në spital është drejtuar vetë nga se edhe dy ditë më parë kishte problem me shëndet, sipas dëshmitarit edhe babai i ka vdekur nga sëmundja e zëmrës në moshën 50 vjeçare.

Jo vetëm nga këtu i akuzuari por as nga ndonjë mjekë tjetër nuk është udhëzuar që shërimin ta vazhdon në Spitalin e .... Për këtë spital ka njohuri nga se një vit me pare e ka pas te sëmur edhe bashkëshorten ku edhe ka bërë korona rografi-a dhe pas kësaj analize, e njëjta nuk ka pas nevojë për intervenim - vënien e stendës. Është e vërtetë se këtu i akuzuari Dr.L e ka shoqëruar për ne Spitalin e ..., se bashku me djalin e motrës Dr.S.U, në mënyrë qe t'ia përcillte gjendjen e tij, për shkak te përkeqësimit te gjendjes dhe është e vërtetë se ne Klinike është dërguar me autoambulance te Spitalit. Këto fakte te deklaruar nga dëshmitari i bëjnë edhe me te qëndrueshme edhe vet mbrojtja e te akuzuarit i cili pohon se këtu dëshmitari-pacienti A. G, me vetë dëshirë dhe dëshirë te familjarëve ka vendosur për te shkuar në spitalin ... ne .... Ky dëshmitar i takon listës se pacienteve të transferuar për korona rografi nga Njësia Koronare e Spitalit Rajonal ne ..., ne muajin Shkurt, nen numër rendor 2, kur ishte kujdestar këtu i akuzuari por nga vet këtu dëshmitari, mbrojtja e akuzuarit dhe transaksionet bankare te ...Bankës, nuk rezulton se këtu i akuzuari e ka obliguar për ne spitalin “...” ne ... por, ai ka shkuar me vete dëshirë dhe me pajtimin e familjareve, një herrit ne transaksionet bankare nuk rezulton se këtu i akuzuari ne rastin ne fjale ka pranuar si provizion shumen e te hollave siç pretendon akuza.

Sa i përket listave te pacientëve të transferuar për korona rografi nga Njësia Koronare e Spitalit Rajonal ne ..., e muajit Mars, Prill, Maj, Qershor, Shtator, te vitit 2012, rezulton se asnjë pacient nuk është transferuar për ne Klinikën “...” te ..., kur ishte kujdestar Dr. LR. Sa i përket listës se muajit Janar, qe i referohet pacientit me numër rendor 7, me emër YH, ne këtë rast siç e shpjegon edhe vete këtu i akuzuar dhe nga lista shifet se këtu i akuzuari ka qene mjek i parë (verifikim i gjykatës mjek i repartit), kurse i dyti është D.N (verifikim i gjykatës mjek i emergjencës), pacienti sipas te akuzuarit ka qene i hospitalizuar më herët ne repartin e Inertno's dhe ka qenë nën kujdesinë e një mjeku tjetër, por nuk i kujtohet se të kujt, nga i cili me siguri ka qene i udhëzuar që të bëj korona rografi, atë dite këtu i akuzuari e ka marr kujdestarinë në orën 15.00 dhe pas 20 minutave, kanë ardhur familjarët e tij, e kanë marr dhe e kanë dërguar në Gjakovë, pacientin e ka vërejtur vetëm duke shkuar, është ofru vëllai i tij N.H, dhe është drejtuar me fjalët Doki-doktor, e kam pacientin timin dhe po shkojmë me dërgu në .... Lidhur me këtë rast i akuzuari vetëm është informuar si kujdestar se është marr pacienti dhe është dërguar në Gjakovë, për trajtim të mëtutjeshëm, e për të cilin më vonë ka kuptuar se korona rografi-a i ka dal mirë.

Për sa i përket listës së muajit korrik të vitit 2012, që i referohet pacientit nën nr. rendor 15 nën emrin B.GJ, ne këtë rast siç shihet nga lista, mjek i parë ka qenë Dr.D.N, këtu i akuzuari Dr. L.R, ka qene mjek i dytë - mjek i emergjencës, i cili ne mbrojtjen e tij te dhënë ne shqyrtim gjyqësor është sqaruar se mjeku i dytë kur e ka radhën e kujdestarisë, kujdestaron në emergjencë dhe nuk ka qasje në repart, respektivisht pacienti i repartit mjekohet nga mjeku i reparti, pacienti ne fjale ka qenë i shtrirë i hospitalizuar edhe më parë, me gjithë atë, atë natë si mjek i parë ka qenë D N dhe lidhur për këtë rast, Dr.D.N, është akuzuar për vepër te njëjtë, dhe nga Gjykata Themelore në Gjakovë ashtu ne mungese te provave është liruar (verifikim i gjykatës aktgjykimi i Gjykatës Themelore ne Gjakove P nr. 364/13 i dt.04.12.2014). Për sa i përket listës së muajit Janar dhe Gusht të vitit 2012, ne Janar qe i referohet pacientit nen numër 1 me emrin R.L dhe muajit Gusht që i referohet pacientit nën nr. rendor 4, nen emrin D.SH edhe ne këto raste i akuzuari ka qene mjek i dytë, çka do te thotë se apsolutisht këta dy pacient jo vetëm qe nuk janë transferuar nga këtu i akuzuari, por te njëjtit nuk janë transferuar as ne Spitalin “...” ne ... por, ne ..., (e qe nuk janë objekt akuze).

Nga fletë lëshimi me epikrizë me nr.historise 3615, data e pranimit të pacientet 12.11.2012, qe ka te beje me pacientin I M Z, rezulton se pacienti është transferuar ne Qendrën Invazive ne ..., e jo ne ... qe nuk është objekt akuze, nga se akuza ka te beje vetëm me pacient qe janë transferuar ne Klinikën ... ne ... Me gjithat i akuzuari gjate mbrojtjes se tij i referohet edhe këtij fletë lëshimi që ka të bëjë me, nr.historise 3615 dt. pranimit të pacientet 12.11.2012 dhe lëshimi i tij po të njëjtën ditë, Prokuroi këtë provë e ka konsiderua si provë për çka edhe akuzohet se pse pacienti për shërim është drejtuar në ... nuk shkruan diegnoza infarkt akut, por diagnozë Oedema pulmonum – mushkërisë. Në një sqarim të dhënë nga i akuzuari se çka duhet të trajtohet si trajtim intenziv shkruan kongjestioni pulmonal i mushkërive, qe ne gjuhen shqipe është mbushje e mushkërive me ujë, ka mbushje te vogël, e vole, e madhe dhe maksimale, e mbushje maksimale e mushkërive me ujë është Oedema pulmonum – edema e mushkërive, dhe në këtë fletëlëshim mjek kujdestar i parë është R.E, kurse i akuzuari mjek i dyte i emergjencës në këtë rast. Në këtë fletë lëshim rezulton se data e pranimit të pacientit është 12.11.2012, dhe është konstatuar edhe data e njëjtë e lëshimit, kurse sipas përshkrimit për transferimin e pacientit në ...konstatohet se të nesërmen nga mjekët kujdestar dr.R.E dhe Dr.L.R, pacienti është transferuar në Qendrën invazive në ... dhe sipas mendimit të akuzuarit në rastin konkret kur është konstatuar date e pranimit dhe lëshimit të pacientit është bërë lëshim teknik. I akuzuari deklaron se ky pacientë ka qenë, dhe me që janë të shënuar tre mjekë dhe është pranuar një ditë më parë ka qenë nën përkujdesje të njërit nga këta tre mjekë. Kjo diagnozë e cekur në fletëlëshim është mjaft e rrezikshme dhe nëse pacienti menjëherë nuk udhëzohet për shërim qind për qind vie gjer te vdekja e pacientit. Pacientë me këtë diagnozë nën kujdesin e mjekut vdekshmëria është nën 40 %. Edhe njëherë sqarohet se pacientin I. M.Z, i akuzuari personalisht nuk ka njohuri se çka ka ndodhur me te dhe nën kujdes të kujt ka qenë dhe nga kush është trajtuar. Deklaron se çdo mjek i cili merr pjesë ne çfarëdo mjekimi apo dhënie të rekomandimi të pacientët për shërim të mëtutjeshëm duhet të nënshkruhet në fletë-lëshimin në fjalë e në rastin konkret nuk është nënshkrimi i akuzuarit , pse nuk gjendet asnjë nënshkrim apo vulë në këtë fletë lëshim i akuzuari nuk ka njohuri.

Nga dëshmia e dëshmitarit H.B, gjykata ka vërtetuar se Klinika private për sëmurje te zemrës ”...”, ne te cilin ka qene si menaxher, tani International Hospital ne ..., veprimtarin e vet e ka filluar ne vitin 2009, e jo nga viti 2007, siç pretendon akuza qe këtu i akuzuari ne periudhën kohore 2007-2012 ka keqpërdor detyrën zyrtare . Këtu te akuzuarin L.R e nje si mjek sikur edhe mjeket tjerë, kur ka bere prezantimin e veprimtarisë se Klinikës Private te tij ne Spitalin e .... Me L nuk ka pasur kurrfarë marrëveshje qe ka te beje me dërgimin e pacienteve nga Spitali Regjional ne ... për ne Klinikën private ne ..., me qellim te vendosjes se standave, e as për kontraktimin dhe pagimin e kompensimit ne para i cili ne mënyrë te qarte ka pohuar se me L nuk kishte pasur kurrfarë marrëveshje as gojore as me shkrim ne raport me dërgimin e pacienteve për mjekim ne spitalin e tij privat , njëherit nuk i kujtohet qe Dr L, ti këtë dërguar paciente. Dëshmitari me tutje ka pohuar se Klinika private për sëmundje te zemrës “...”, e me vone “...”, ne ..., është marre me sponsorimin e mjekeve ne kongrese, konferenca ndërkombëtare dhe kombëtare, si dhe ne seminare trajnime tjera profesionale mjekësore, sepse kështu veprohet ne tere boten me qellim te edukimit te vazhduar te mjekeve dhe mjekeve specialistë.

Ne aktakuze thuhet se këtu i akuzuari ka marre shpërblim nga pronari i Klinikës private “...”, për çdo pacient shumen prej 300-400 €, gjithsejtë ne këtë mënyrë ka përfitur shumen prej 1.500 € (njëmijepesëqind)euro, por nuk thuhet asgjë se kush e beri këtë pagese, kujt i është bere pagesa dhe ne çfarë mënyre, prokurori i shtetit nuk i ka ofrua gjykatës asnjë prove materiale me te cilën do ta argumentonte se i akuzuari ka perfituar “pasuri”, te kundërligjshme për udhëzimet e këtyre

pacienteve ne këtë spitale, siç thuhet ne aktakuze askush nuk di, madje as prokurori qe ka cek ne aktakuze se te hollat për udhëzimin e pacienteve ne spitalin... te akuzuarit i u janë paguar nga pronari i Klinikës H.B përmes llogarisë, është e pa mbështetur ne provat materiale nga se gjykata posedon ekstraktin bankar nga ... banka për te akuzuarin dhe atë për periudhën kohore te evidentuar nga ky ekstrakt nuk mund te argumentohet një thënie e tille nga se ne llogari bankare te akuzuarit nuk është asnjë pagese e bere nga Klinika private “..”, andaj pretendimi i tille i akuzës bie poshtë ne mungese te provave. Ashtu qe Gjykata nga provat e administruara ne shqyrtim gjyqësor, nuk ka vërtetu elementin baze te veprës penale përfitimin pasuror te kundërligjshëm.

Nga raporti i masave te fshehta – listingu i hyrje daljeve dhe mesazheve te numrave te telefonave te Dr. L.R .... dhe H.B ..., gjykata ka vërtetuar se bisedat e bëra telefonike dhe këmbimi i SMS-ve, ishin biseda te rëndomta dhe këmbimi i urimeve te festave ne mes te akuzuarit dhe këtu dëshmitari H.B , nuk është vërtetuar asgjë konkrete lidhur me dërgimin e pacienteve me infarkt akut nga i akuzuari ne Spitalin ... apo sot ... ne ... për vendosjen e stendave, gjithashtu nga listingu i hyrje daljeve dhe shkëmbimi i mesazheve nuk përmendet as emri dhe mbiemri i asnjë pacienti , pra nuk është identifikuar asnjë pacient i dërguar e qe nuk ceket as ne dispozitiv te akuzës, një herrit nuk është identifikuar as shuma e te hollave qe spitali ne fjale ia ka paguar apo do t’ia paguaj te akuzuarit , apo biseda te ngjashme nga te cilat është vërtetuar se ne mes te akuzuarit dhe drejtorit te klinikës ka ekzistuar marrëveshja për dërgimin e pacienteve për vendosjen e stendave me shpërblim ne para te cilat fakte i mohon edhe vet drejtori i klinikës këtu dëshmitari H. B. ne deponimin e tij te dhënë ne shqyrtim gjyqësor.

Nga shkresa e Ministrisë se Drejtësisë – Inspektorati i Shëndetësisë e dt.03.06.2013, nr.reference 10-E--018-013, drejtuar te gjitha Institucioneve Shëndetësore, për njoftim te hyrjes ne fuqi te Ligjit për shëndetësi me numër 04/L-123 datës 22 maj 2013, e posaçërisht respektimin e nenit 41 qe i referohet – parandalimit te konfliktit te interesit i cili përcakton me afër siç është përshkruar ne këtë shkrese, e ne rast mos respektimit te se njëjtës pason sanksioni me gjobe dhe marja e licencës se profesionistit shëndetësor ne kohëzgjatje prej 6 muaj gjer 1 një vit , me gjithat gjykata vlerëson ky ligj i referohet periudhës kohore pas vitit 2012 për te cilën akuzohet i akuzuari, çka do te thotë i referohet periudhës kohore nga muaji maj i vitit 2013.

Nga parashtesa e Prof. B.Z ushtrues detyre Drejtor i Klinikës së Kardiologjisë dhe angiologjisë, drejtuar Ministrit të shëndetësisë Prof. Dr.F.A nr.protokoli 807 dt.28.02.2014 – Arkivi i QKUK-së, gjykata ka vërtetuar e qe rezulton nga kjo shkrese se infarkti akut nuk eshët trajtuar nuk trajtohet a as nuk do te trajtohet edhe ne një te ardhme te afërt ne QKUK e sidomos ne periudhën kohore për te cilën akuzohet këtu i akuzuari.

Nga certifikatat e pjesëmarrjes së këtu të akuzuarit në Seminare dhe Kongrese, fale sponsorizimit te bere nga Spitali “...” ne Gjakovë, si dhe Klinikave tjera, siç kanë pohuar edhe vete i akuzuari dhe dëshmitari - ish Pronari i Spitalit “...” ne ..., te akuzuarit si dhe mjekeve tjerë iu është mundësuar pjesëmarrja ne kongrese , konferenca dhe seminare te karakterit kombëtar dhe ndërkombëtar me qellim te edukimit dhe avancimit te vazhduar profesional te mjekeve specialiste, pra edhe këtu te akuzuarit ashtu siç vepronet ne tere boten e përparuar.

Nga Urdhëresa e Spitalit Rajonal në ..., nr.414/1 te dt.08.09.2011, e marre nga konkluzionet e mbledhjes se këshillit profesional, është e vërtete, e qe mes tjerash rezulton se te gjitha rastet tjera qe nuk janë infarkt i miokardit me elevacion duhet te trajtohen ne njësinë koronare te

stabilizohet gjendja e pastaj te planifikohet dërgimi i tyre ne QKUK, ndalohet dërgimi emergjent i te gjitha rasteve qe prezantojnë ne Spitalin rajonal te ... gjate kujdestarisë përveç infarktut akut te miokardit me ST elevacion, nëse është kërkesë e familjareve të pacientit për dërgim ne Qendrat private kardiologjike, mjeku kujdestar nuk guxon ta lëshoi kujdestarinë për përcjellje te pacientit me autoambulance te spitalit, obligohen mjeket qe te kompletojnë dokumentacionin mjekësor për rastet me IM me ST elevacion dhe EKG-ne.

Nga shkresa zyrtare e spitalit regjional në ..., nr.01/506/1 dt.01.10.2012, ne përgjigjen e Drejtorit te Spitalit ne ... drejtuar organeve hetimore gjykata ka vërtetuar se sa i përket referimit te pacienteve, spitalet sipas organo-gramit, janë te obliguar ti udhëzojnë pacientet ne QKUK ne ..., për rastet te cilat nuk mund te trajtohen ne QKUK, siç janë edhe ato te Kirurgjisë se zemrës, nuk ekziston ndonjë vendim i organeve kompetente, përpos qe ligji dhe Kodi i Etikës Mjekësore obligon mjekun ta njofton pacientin mbi natyrën e sëmundjes dhe mundësin e trajtimit.

Sipas gjykatës, nga provat e administruara respektivisht dëshmitari G.G dhe vet mbrojtja e te akuzuarit dhe provave materiale gjykata ka vërtetuar se pacienti ne fjale G.G është diagnostifikuar me diagnoze infark akut te miokardit me S.T. elevacion dhe, pas përfundimit te gjitha analizave i njëjti nga mjeket është njoftuar mbi natyrën e sëmundjes dhe mundësin e trajtimit, edhe pse pike kyçe ishte QKUK, me qenë se në atë kohe ky intervenim nuk kishte mundësi te trajtohet ne QKUK, i njëjti kishte njohuri për kliniken ... ne ... siç pohon edhe vet dëshmitari ne deponimin e tij se me pare disa familjare dhe bashkëshortja janë trajtuar ne Klinikën ne ... me pëlqimin e tij dhe te familjareve te tij kane vendosur qe te shkojnë ne ... . Për veprimet e te akuzuarit, qe pacienti ne fjale është dergu me autoambulancën e spitalit dhe i njëjti ka qene ne përcjellje edhe te këtu te akuzuarit, Gjykata konstaton se ne dispozitiv te akuzës nuk janë cek këto veprime te akuzuarit se a paraqesin shkelje te ndonjë ligji apo rregullore nga te cilat dispozita do te përcaktohej përgjegjësia penale e këtu te akuzuarit, pra ne aktakuze nuk janë konkretizuar këto veprime konkrete si veprime konkrete te përcaktuara me ndonjë ligj apo rregullore si veprime inkriminuese te cilat do te paraqitnin elementet e veprës penale nga te cilat rrjedh përgjegjësia penale. Andaj sipas vlerësimit te kësaj gjykata këto veprime te akuzuarit nuk paraqesin përgjegjësi penale por mund te paraqesin përgjegjësi disiplinore e qe nuk mund te përcaktohen ne procedurën penale por përcaktohen vetëm ne procedure disiplinore te zhvilluara nga organet disiplinore e jo nga organet gjyqësore nga se kjo nuk është objekt i procedurës gjyqësore, e sidomos bazuar ne faktin se me asnjë prove te administruar ne shqyrtim gjyqësor nuk është vërtetu elementi baze i veprës penale për te cilën akuzohet i akuzuari keqpërdorimi i detyrës zyrtare – përfitimi pasuror i kundërligjshëm.

Andaj nga arsyet e theksuara me larte konsiderojmë se ne veprimet e te akuzuarit L. R nuk ekziston asnjë element i veprës penale për te cilën është akuzuar me aktakuze, dhe se prokuroria nuk ka ofruar asnjë prove relavante për vërtetimin e ekzistimit te veprës penale qe i vihet ne bare te akuzuarit. Nga provat e administruara gjykata ka vërtetuar një gjendje tjetër faktike nga ajo qe është dhënë ne aktakuze dhe kjo është bere me arsye te bazuara ne favor te akuzuarit.

Nga arsyet se i akuzuari... u liruar nga akuza , shpenzimet e procedurës penale u bien ne barre mjeteve buxhetore te gjykatës.

Duke u bazuar ne nenin 364 par.1 pika 1.3 te KPPK-se, u vendos si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.



Duke u bazuar ne nenin 368 te KPPK-se, Gjykata palët ne procedure i njoftoi me paralajmërimet qe shoqërojnë aktgjykimin.

**GJYKATA THEMELORE PEJË - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA,  
P .nr. 403/13 të dt.11.12.2014**

**Sekretarja Juridike  
Shpresa Kërnya**

**Kryetarja e Trupit Gjykues  
Lumturije Muhaxheri**

**Anëtarët e trupit gjykues**

**1.Violeta Husaj Rugova\_\_\_\_\_**

**2.Kreshnik Radoniqi \_\_\_\_\_**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës se Apelit ne Prishtinë, e përmes kësaj gjykate